



Prishtinë: 16.05.2014

Kodi i ZRRE-së: V\_628\_2014

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1084\_01\_14**;
- Ankesa e KEDS-it e datës 28.04.2014.

në seancën e mbajtur më datë 16 maj 2014, nxorri këtë:

### V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e KEDS-it ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin B. H. me shifër të konsumatorit: DPR – 90029633) nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_1113\_04\_14 i datës 02.04.2014.

### Arsyetim

Me datë 04.07.2013 punëtorët e autorizuar të KEDS për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse te konsumatori, ku kanë theksuar se: *“prej se jam lexues në teren te konsumatori i lartcekur nuk ka pas banim prej se jam lexues dhe objekti ka qenë i shkyçur dhe mbetet i shkyçur”*.

Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEDS me të cilën ka kërkuar nga ta që të bëjë shlyerjen e borxhit të energjisë elektrike të ngarkuar për taksën mujore. Konsumatori ankesën e tij e ka bazuar në faktin se nga muaji 07/2005 ka qenë i shkyçur nga rrjeti elektrik nga KEK-u, pasi që i është djegur i gjithë rrjeti elektrik së bashku me njehsorin dhe nga kjo periudhë i njëjti është ngarkuar vetëm me taksë mujore. Andaj ka kërkuar nga KEDS që të shlyej të gjithë borxhin e energjisë elektrike të ngarkuar nga KEDS për taksën mujore nga periudha 07/2005 e tutje.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 25.07.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kërkuar nga KEDS që të shlyej të gjithë borxhin e energjisë elektrike të ngarkuar nga KEDS për taksën mujore nga periudha 07/2005 e tutje, pasi që nga kjo periudhë kohore ka qenë i shkyçur nga rrjeti elektrik për shkak se i është djegur i gjithë rrjeti elektrik së bashku me njehsorin. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 02.04.2014 ka nxjerr vendim duke e **aprovuar** ankesën e konsumatorit dhe duke kërkuar që: 1) Konsumatori B. H. me shifër DPR - 90029633 obligohet t'i paguaj KEDS-it-së gjithë borxhin e krijuar deri në periudhën e muajit 06/2005; 2) KEDS-i obligohet që konsumatori B. H. me shifër DPR- 90029633 t'i bëj shlyerjen e gjithë borxhit të ngarkuara me taksa



mujore nga periudha 07/2005 deri më tani dhe pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi KEDS obligohet që t'i pasivizoj shifrën e këtij konsumatori.

Baza e kundërshtimeve të KEDS-it të theksuara në ankesë është se DMK e ZRRE-së, gabimisht ka bërë vlerësimin e provave dhe shkresave të prezantuara të lëndës për faktin se në bazë të shënimeve që disponon KEDS-i, taksa fikse i është faturuar në bazë të rregulloreve të ZRRE-së, gjithashtu theksohet se nuk është kontestues procesi i kontrollës së KEDS-it, ku thuhet se edhe vet njehsori është djeg. Gjithashtu konsumatori ka qenë i obliguar që të bëjë pagesën e borxhit dhe të kërkoi masivizimin e deri në zgjidhjen e problemit të shtëpisë. Nga shënimet që disponon KEDS konsumatori është pasivizuar me datë 04.09.2013. KEDS thekson se bazuar në këtë nuk ka asnjë argument të vlefshëm mbi të cilën bazë duhet të shkarkohet konsumatori nga faturat e lartcekura, arsyetimet e konsumatorit në ankesë kanë qenë të pabazuara dhe të bëra me qëllim që ti shmangen përgjegjësisë.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16 maj 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, përkatësisht bazën e kundërshtimit dhe pas vlerësimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vlerësuar se argumentet e prezantuara nga ana e KEDS nuk janë bindëse për faktin se me asnjë provë nuk ka argumentuar se DMK ka bërë gabimisht vlerësimin e provave gjatë vendosjes së kësaj çështje. Arsyet e theksuara në ankesë janë se konsumatori ka qenë i obliguar të bëjë pagesën e borxhit pastaj të bëjë kërkesën për pasivizimin e njehsorit elektrik. Bordi i ZRRE-së ka konstatuar se lidhur me inkasimin e borxhit është përgjegjësi e vet ndërmarrjes, ndërsa sa i përket pasivizimit të njehsorit elektrik kjo pikë matëse ka qenë e djegur shtëpia me gjithë njehsorin elektrik fakt që është vërtetuar edhe nga vetë punëtorët e autorizuar për inspektimin e pikës matëse, si dhe në procesverbal theksohet se konsumatori ka qenë i shkyçur dhe mbetet i shkyçur në shtyllë. Në rastin konkret ndërmarrja ka qenë e obliguar që të mos e ngarkoi konsumatorin me taksa mujore pasi që i njëjti nuk ka marr asnjë shërbim për të paguar taksë.

Sa i përket pjesës së borxhit të pa inkasuar ndërmarrja ka qenë e obliguar të veproi konform dispozitës së nenit 5 paragrafi 2 nën-paragrafi 2.4 të Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji ku theksohet: *“furnizuesi duhet të faturojë dhe të arkëtojë (mbledh) pagesat prej konsumatorëve, andaj në këtë rast KEK në atë periudhë ka qenë e obliguar të inkasoi këtë borxh në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi”*.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se KEDS në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 16.05.2014 ka analizuar ankesën e KEDS dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_1113\_04\_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar